

KOALICIONI PËR KOMRA

DRAFT STATUTI I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS DHE SHKELJEVE TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË HAPËSIRAT E JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME

PJESA II. – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Definicioni

1. Komisioni regjional për vërtetimin e provave (fakteve), mbi krimet e luftë dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut në hapësirat e ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), është Organizatë Ndërkombëtare e themeluar me këtë akt ligjor.

Komentet

KOMRA është një organ ndihmës, mbështetës për sistemin ligjor, për nevojën e sjelljes kualitative të vendimeve. Kjo duhet të jetë në nenin 1. (Salih Rasovac, Corridor, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

2. Shkurtesa është KOMRA.

Neni 5

Periudha e veprimit

1. Periudha e veprimit të Komisionit është tri vjet.
2. Periudha e veprimit të Komisionit nuk përfshinë periudhën e përgatitjeve e cila fillon nga mbledhja konstitutive dhe vazhdon, më së gjati gjashtë muaj.
3. Komisioni mund ta vazhdojë (zgjasë) periudhën e veprimit më së shumti për gjashtë muaj.

Komentet

(...) propozoj që nga paragrafi 3 të shtohet paragrafi 4. – „komisioni, me kërkesë të më së paku tri shteteve nënshkruese, mund të thirret në përmbajtje të plotë, në afat prej shtatë ditësh, posaçërisht në zbatim të nenit 11, të statutit, paragrafi prej b deri në f“. (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 6

Përfaqësimi dhe paraqitja

1. Komisionin e përfaqëson dhe paraqet kryesuesi/ja e Komisionit.
2. Komisioni mund të vendos që ta përfaqësojë një anëtarë/re tjetër.

Komentet

(...) duhet t'i përcaktojmë disa kushte sipas të cilëve komisionin mund ta përfaqësojë dikush tjetër përpos kryetarit të komisionit. (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

PJESA E III – OBLIGIMI I BASHKËPUNIMIT ME KOMISIONIN

Neni 10

Obligimi i bashkëpunimit të shteteve me Komisionin

1. Të gjitha organet e pushtetit në shtetet kontraktuale, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe të njëjtit ti mundësojnë kryerjen e detyrave në përputhje me Statutin.
2. Organet kompetente të pushtetit në shtetin kontraktues, në kërkesë të Komisionit, me kohë do të sigurojnë qasje në të dhëna, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave dhe zbatimin e hulumtimeve në teren,

[ALT. A: në përputhje me dispozitat ligjore të shteteve.]

[ALT. B: përveç nëse me këtë do shkeleshin dispozitat ligjore të shtetit kontraktues mbi konfidencialitetin e të dhënave, ose nëse do të rrezikohet zbatimi i procedurës penale. Të dhënat, ose dokumentet, që kanë për qëllim fshehjen e veprës së kryer penale, ose që janë të drejtuara në shkelje të rënda të drejtave themelore të njeriut, nuk konsiderohen sekret shtetëror, ushtarak ose zyrtarë]

3. Me rastin kur shteti konsideron që zbulimi i të dhënave të caktuara ose dokumenteve të cilat i ka kërkuar Komisioni do rrezikonin interesat ose sigurinë e tyre nacionale, do të ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të tejkalimit të situatës kontestuese, me angazhim të përbashkët të Komisionit dhe Shtetit. Këto masa nënkuptojnë:
 - (a) Deklarimi i Komisionit lidhur me atë sa janë relevante të dhënat dhe dokumentet të cilat i kërkon;
 - (b) Sqarimi ose ndryshimi i kërkesës,
 - (c) Shqyrtimi i mundësive të marrjes së të dhënave ose dokumenteve nga një burim tjetër ose në një mënyrë tjetër;
 - (d) Marrëveshja mbi kushtet e zbulimit të dhënave, duke përfshirë, ndër të tjera, zbulimin e pjesshëm të përmbajtjes së dokumenteve, kufizimi në publikimin e të dhënave si dhe zbatimin e masave tjera mbrojtëse mbi konfidencialitetin e të dhënave.

Komentet

Ne nuk mund t'a përcaktojmë me status obligueshmërinë e shteteve për bashkëpunim (...), statuti merret me punën e komisionit, ai nuk mundet të përcaktojë obligueshmërinë e shteteve për bashkëpunim, kjo çështje duhet të jetë subjekt i marrëveshjeve ndërshtetërore. (Vesna Simoviq, Shoqata e Avokatëve, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

PJESA E IV. – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISIONIT

Neni 11

Qëllimet e Komisionit

Komisioni ka këto qëllime:

- a) të vërtetojë provat (faktet) për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat në ish RSFJ, në periudhën nga 1 Janari të vitit 1991 deri me 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat shoqërore dhe politike të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të drejtave;

Komentet

(...) në paragrafin a, duhet të definohen pasojat të cilat i kanë shkaktuar krimet dhe shkeljet e të drejtave. (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) duhet ta vërtetojmë se kush është përgjegjës për të gjithë atë çka ka (...) ndodhë, kush e bartë i pari përgjegjësinë në hierarki, “kush e ka filluar”; siç do të thuhej “luftën në vendin tim”. Pa këtë pjesë do ta lëmë sërish mundësinë e manipulimit, siç po manipulohet tani, mund të flas për shtetin tim, numrin e viktimave, numrin... (Murat Tahirovqi, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit në Bosnjë e Hercegovinë, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) shkaqet, vërtetimi i shkaqeve dhe të gjithë ata që angazhohen për këtë çështje, e vënë komisionin para një detyre absolutisht të pamundur, të përealizueshme, që tek e fundit që në fillim pajtohem me atë se komisioni nuk do të mund të ketë sukses në punë e tij, prandaj, ju lutem, ta keni parasysh këtë (...) Ajo që më duket relevante në këtë aspekt, është se komisioni ofron mundësinë që të vërtetohet motivi për kryerjen e krimeve të luftës, gjegjësisht krimin kundër njerëzimit apo gjenocid. (Zoran Pajiq, Bordi udhëheqës i Fondit për të Drejtën Humanitare, USA, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë

tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) grupet punuese dhe avokatët [janë] duke u larguar ngadalë nga nocioni i viktimës, prandaj nuk e kam të qartë, dhe që faktikisht që në fazën fillestare pengon krijimin e kategorive **që të vërtetohen faktet e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.** (Ljiljana Canjuga, Shoqata e vullnetarëve dhe veteraneve të luftës çlirimtare, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

- b) të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në shtetet kontraktuese të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda e të drejtave të njeriut.

Komentet

(...) paragrafin b ta riformuloni, që njëri ndër nënqëllimet e KOMRA-së të jetë ngritja e nivelit të vetëdijesimit në shtete nënshkruese për nevojën që t'i pranojnë faktet për krimet e luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. (Vesna Simoviq, Shoqata e avokatëve, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

- c) Të kontribuojë në ndriçimin e fatit të humburve – pagjeturve;
- d) Të pranojë padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe dhembshuri për viktimat;

Komentet

(...) mendoj se këtu formulimi nuk është bërë mirë, por **qëllimi do të duhej të jetë ndërtimi i kulturës së solidaritetit dhe ndjeshmërisë, ky do të ishte qëllimi.** (Vesna Simoviq, Shoqata e avokatëve, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

- e) Të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave; dhe
- f) Të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve dhe të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut.

Komentet

(...) kam frikë se nuk do ta dimë se çfarë është qëllimi, e çfarë është detyra. Qëllimet nuk mund të formulohen kështu; për shembull, **qëllimi do të ishte vërtetimi i fakteve, e jo t'i vërtetojmë faktet, sepse kjo është detyrë e cila rrjedhë nga qëllimi i cili është i përgjithshëm** (...) qëllimi i fundit është në fakt qëllimi i përgjithshëm nga i cili rrjedhin të gjithë ata paraprak. Nuk është mirë që ai të radhitet i fundit, por do të ishte më mirë që ai të definohet si qëllim i përgjithshëm i KOMRA-së, dhe nga ai qëllim i përgjithshëm rrjedhin nënqëllimet. (Vesna Simoviq, Shoqata e avokatëve, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) redaktorët e draftit të statutit, **të mendojnë për atë se a ekzistojnë dallimet e vërteta në mes asaj çka quajmë qëllime e çka detyra.** (Zoran Pajiq, Bordi udhëheqës i Fondit për të Drejtën Humanitare, USA, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 12

Komisioni ka këto detyra:

- a. Të grumbulloj të dhëna për rastet e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut dhe krimeve të luftës, të ofrojë përshkrimin detal për to, dhe të pasqyrojë përmes formularëve shkeljet e të drejtave dhe pasojat e tyre;

Komentet

(...) jam i dëshpëruar me punën e grupit punues sepse në të tri konsultimet që kam qenë, e dy kanë qenë me viktimat, kemi folë për gjenocidi, kemi dhënë argumentimin **pse duhet të bëhet vërtetimi i fakteve për gjenocidin si pjesë e detyrës së KOMRA-së, megjithatë, kjo është refuzuar.** (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) duhet të **fshihet formulimi „të sigurojë përshkrim detal të tyre“,** ju lutem, sepse është e qartë se (...) mundësitë objektive të komisionit, kjo do të ishte mision i pamundur. (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

- b. të grumbullojë të dhëna për fatin e të humburve dhe të bashkëpunojë me trupat kompetente të cilat, në shtetet kontraktuese, merren me hulumtimin për të zhdukur;
- c. të bëjë inventarizimin e humbjeve njerëzore për:
 - i. civilët të cilët kanë humbur jetën ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;
 - ii. luftëtarët të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;

Komentet

Në arsyetimin se në afatin kohor prej tri vitesh, që komisioni nuk do të mund të vërtetojë **kush është me të vërtetë viktimë,** në kuptimin e **definimit të viktimës** e kështu me radhë, mendoj se nëse tërë çështja sillet rreth viktimave, që atëherë **mandatin duhet t'ia kushtojmë kësaj,** e jo të humbet kohë në vërtetimin e rrethanave politike dhe shoqërore të cilat kanë sjellë deri të faktet e krimeve, edhe pse është shumë e rëndësishme, por mua më duket si mision i pamundur që ato fakte të vërtetohen dhe të definohen në afatin kohor prej tri vitesh, përderisa njëkohësisht kemi regjistra të shumtë dhe të ndryshëm sipas të cilëve mund të definohet **çka është viktimë.** (Liliana Alvir, Nënati e Vukovarit, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) të gjithë luftëtarët nuk janë viktimë dhe këtu duhet qartë **të përcaktohet dallimi se kur një luftëtar bëhet viktimë** sipas Konventës së Gjenevës. (Liliana Canjuga, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të luftës çlirimtare, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) duhet ta bëjmë dallimin në mes termeve të humbjeve në njerëz dhe të viktimave (...) KOMRA duhet ti caktojë standardet e veta se si, në çfarë mënyre do të vërtetojë listën e të vrarëve (...) ne duam që të gjitha të viktimat pajtohen me metodologjinë e njëjtë, me sistem të veçantë, dhe ta kenë definimin unik në përcaktimin e tyre të regjistrit. (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

- d. të grumbulloj të dhëna mbi vendet e burgosjes të ndërlidhura me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur, dhe të hartojë një regjistrim gjithëpërfshirës;
- e. [ALT. A: të hulumtoj rrethanat politike dhe shoqërore të cilat drejtpërdrejtë kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave, ose i formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut];
[ALT. B: të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, drejtpërdrejtë kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut];
- f. të mbajë dëgjime publike për krime të luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave të njeriut,
- g. të rekomandojë masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të drejtave të njeriut dhe për reparacionin për viktimat;
- h. të hartoj, të publikojë dhe të prezantojë raport përfundimtarë.

Neni 14

Veprat në kompetencën e Komisionit

Krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave me të cilat merret Komisioni përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a. vrasjet;
- b. robërimi;
- c. burgosja e kundërligjshme;
- d. torturimi;
- e. humbjet e përdhunshme;
- f. deportimi dhe zhvendosja e përdhunshme e popullsisë;
- g. dhunimi dhe forma tjera të rënda të keqtrajtimit seksual;
- h. marrjen dhe shkatërrimin e pronës në përmasa të mëdha;
- i. marrja e talarëve;
- j. shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturo-historike;

- k. shfrytëzimi i civilëve dhe robërve të luftës si “mbrojtës të gjallë” .

Komentet

(...) jam thellësisht i dëshpëruar me faktin që grupi punues (...) në nenin 14, nuk e ka radhitur krimin më të rëndë të luftës, e ai është gjenocidi (...) propozoj se **gjenocidi do të duhej të jetë pjesë e mandatit (kompetencës) me të cilën do të merrej KOMRA, që verediktet që janë marrë në lidhje me gjenocidin duhet të merren parasysh me rastin e vërtetimit të fakteve, por edhe në rastin e përpilimit të raportit final.** (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Nëse teksti i draftit nuk e përmban fare **mundësinë e interpretimit se KOMRA nuk do të merret me gjenocidin**, (...) atëherë kjo është **vërejtja** më serioze e mundur në tekstin e draftit. (Drashko Bjelica, Fakulteti Filozofik, Nish, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) ne propozojmë që në nenin 14, në të cilin janë përshkruar veprat që janë në kompetencën e komisionit, **të përfshihet edhe kategoria e shkeljeve më të rënda të drejtave të njeriut, e cila me përmbajtjen e saj do të përfshijë edhe rastin e të fshirëve në Slloveni.** (...) Kategoria të cilën e propozojmë është – “marrja sistematike, arbitrar apo joligjore apo ndalimi i të drejtës në qëndrim të përhershëm apo marrja ose pengimi i të drejtës së nënshtetësisë”. (Jovana Mihajloviq-Trbovc, Instituti i Paqes, Slloveni, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Bëhet fjalë për nenin 14, për të cilin unë propozoj që të **plotësohet edhe me disa paragrafe, “me qëllim dhe/ose fshehja sistematike dhe/apo shkatërrimi i dokumenteve të cilët dëshmojnë apo mund të shërbejnë për zbardhjen e dokumentimit të rasteve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të luftës”.** (Koqa Pavloviq, Deputet në Kuvendin e Malit të Zi, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) krimi i luftës nuk e përjashton gjenocidin (...) emri i komisionit thotë krime lufte, unë e kuptoj se flet për krimin e luftës si një term i përgjithshëm i cili e përfshinë edhe gjenocidin. Natyrisht, të sqarohem menjëherë, duke pasë parasysh se gjatë luftës, në Jugosllavi, gjegjësisht në Bosnjë e Hercegovinë me të vërtetë ka ndodhë dhe është vërtetuar krimi i gjenocidit, për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore, mendoj se pas gjithë këtyre diskutimeve që i dëgjuam, gjenocidin do të duhej radhitur në këtë listë. (Zoran Pajić, Bordi udhëheqës i Fondit për të Drejtën Humanitare, USA, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) mendoj se problemi i të fshirëve mund të radhitet me të vërtetë në shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, dhe nuk do ta ndaja këtë si kapitull të veçantë, por ndoshta do ta radhitja si lëndime konkrete, por duhet të jemi mjaft të hapur për të kuptuar çka nënkupton titulli – krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. (Zoran Pajiq, Bordi udhëheqës i Fondit për të Drejtën Humanitare, USA, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Si shtesë të nenit 14, në paragrafin I, unë do të **shtoja** përveç shkatërrimit të dokumenteve (...) – **frikësimi dhe vrasja e dëshmitarëve**. (Milan Reliq, UG Strugë, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) nëse gjykata ndërkombëtare e ka përcaktuar tanimë, se ai ka qenë gjenocid, **pse atëherë KOMRA i shmanget fjalës gjenocid?** (Persa Vuqiq, Gratë në të zeza, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) të përfshihet gjenocidi dhe **të shënohen të gjitha – gjenocidi dhe të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut, krimet e rënda (...)** pse nuk po përdoret edhe termi **edhe vrasjet e fëmijëve (...)** mundemi të shtojmë edhe veprimet specifike, të themi [të fshirët], për **Sllovenët**. (Aprilija Luzhar, Taxiart, Slloveni, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Pse është kaq e rëndësishme që ky krim [të fshirë] të radhitet në listën e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut? Për arsye sepse as nuk bëhet fjalë për shkeljen e të të drejtave të drejtave të njeriut, por për diçka që është një hap më para, bëhet fjalë për **marrjen e të drejtës që të kesh të drejtë**. (Vlasta Jalushiq, Instituti i Paqes, Slloveni, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Ne nuk po kërkojmë që KOMRA të vërtetojë përgjegjësinë individuale, por kërkojmë që KOMRA të vërtetojë faktet për gjenocidin, sepse në këtë mënyrë pastaj nuk do ta bëjmë revidimin e vendimeve (verdikteve). (Amir Kulagliq, Anëtar i Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Objektivat dhe Detyrat e KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

KOALICIONI PËR KOMRA

DRAFT STATUTI I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS DHE SHKELJEVE TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË HAPËSIRAT E JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME

PJESA V – KOMPETENCAT E KOMISIONIT

Neni 13

Kompetenca kohore dhe territoriale e Komisionit.

Komisioni vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet të rënda të drejtave të njeriut, të kryera në periudhën nga data 1 Janar 1991 deri me 31 dhjetor 2001, në shtetet në hapësirat e ish RSFJ, dhe hulumton:

- [ALT . A: rrethanat politike dhe shoqërore të cilat drejtpërsëdrejti kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose i formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerja e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut];
- [ALT – B: rrethanat politike dhe shoqërore, duke filluar nga viti 1980, drejtpërsëdrejti kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose i formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkelje të rënda e të drejtave të njeriut].

Komentet

Pse nuk merret viti '90-të? Sepse ne kemi probleme në vitin '90 në Kroaci. Ne kemi logs. Ne kemi pamundësimin e rrjedhës së mallrave, njerëzve, të mjeteve, dhe çdo gjë tjetër. Kemi konflikte të armatosura sporadike në vitet '90. Ne kemi viktimë të vitit '90-të. Nëse e aplikojmë këtë, atëherë ata njerëz kanë rënë. (Veljko Viqueviq, mbrojtës, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

Neni 22

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

1. Anëtari/anëtarja e Komisionit është:
 - a. Shtetas/shtetase e shteteve kontraktuese;
 - b. Person me kualitete të larta morale, me integritet dhe autoritet, i përkushtuar dialogut tolerant dhe konstruktiv për zgjidhjen e kontesteve, i cili mund të gëzojë besimin në të gjitha shtetet kontraktuese, dhe
 - c. Person me aftësi psiko-fizike për kryerjen efikase dhe në kontinuitet të detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit.
2. Shteti kontraktues zgjedhë më së paku një grua, gjegjësisht më së paku një burrë, për anëtarë ose anëtare të Komisionit.
3. Shteti kontraktues, me rastin e zgjedhjeve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit do të përkushtohet që të sigurojë edhe përbërjen reprezentative etnike të komisionit, në atë mënyrë që krahas pjesëtarit/pjesëtares nga radhët e Bashkësisë më të madhe në numër, do të mundohet që të zgjedhë edhe njërin/njërën ose më shumë pjesëtarë/pjesëtare nga bashkësia tjetër etnike, gjegjësisht nga bashkësitë tjera etnike në atë shtet kontraktues

Komentet

Kërkoj që të qartësohet në mënyrë precize dhe koncize, çfarë do të thotë “të provojë”? Çfarë mendoni me fjalët – “të provojë të sigurojë”? (...) çka do të ndodhte me shtete që i kanë vetëm nga dy anëtarë në KOMRA? (Bekim Blakaj, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

4. anëtarë/anëtare e Komisionit nuk mund të jetë personi:
- a. Që ka ushtruar funksion politik në dy vitet e fundit, para shpalljes së konkursit për zgjedhje të anëtarëve/anëtareve të Komisionit, ose në periudhën kohore e cila është përfshirë në kompetencën e Komisionit;

Komentet

(...) është e nevojshme të definohet saktë funksioni politik. (Ivan Novosel, Legalis, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

Neni 22. me emërtimin – „Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve /anëtareve të komisionit“, paragrafi 4. paragrafi a, propozoj që kjo si e tillët të fshihet. Kush ka mundë, në cilëndo pjesë të ish vendit tonë, t'i kundërvihet strukturës shtetërore të atëhershme.? Ai do të shpallej menjëherë ose tradhtarë ose do ti kishte ndodhë diçka që do ta kishte humbë jetën. (Miloslav Stojković, Qendra për mbrojtjen e familjeve e viktimave të luftës në Kosovë e Metohi, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

- b. I cili (cila) ka qenë pjesëtar i strukturave ushtarake, policore, informative si dhe strukturave të tjera të sigurisë;

Komentet

Unë si njeri, jam kundër këtij neni, sepse, mendoj se diskriminon një numër të madh të qytetarëve në territorin e ish RSFJ-së (...) Unë nuk besoj se të gjithë kanë qenë kriminel luftime (...) Pse do të bënte krim luftime një ushtar profesionist? (Veljko Viqueviq, mbrojtës, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

Nëse ai person ka qenë pjesëtarë i ndonjë strukture sigurie, ushtarake, policore apo informative (...) ai nuk mund të jetë person objektiv, ai nuk mund të gjykojë në mënyrë objektive. Sepse ai do të ketë punë me kolegët e tij, me ish ushtarët e tij, me ish policët. (Faton Ademi, Balkan Investigative Reporting Netëork, Kosovë, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

(...) propozoj (...) që paragrafi (...) b, eventualisht të ridefinohet dhe të jetë – formacionet parapolicore, paraushtarake, (...) por faktet flasin se të këqijat më të mëdha në tërë territorin e ish Jugosllavisë e kanë bërë ato formacione, të cilat kanë pasë legjitimitetin.

(Miloslav Stojković, Qendra për mbrojtjen e familjeve e viktimave të luftës në Kosovë e Metohi, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

- c. për të cilin/cilën ekziston dyshimi i bazuar se është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, ose ka mbështetur, ndihmuar ose nxitur kryerjen e veprave të tilla, ose ka kontribuar në mos dënimin e atyre veprave, ose është në lidhje të ngushta me personin e gjykuar, akuzuar ose që është nën hetime për vepra të tilla.

Komentet

Kush do ti kontrollojë kriteret (...) cili organ do të merret me këtë, që me të vërtetë të aplikohen të gjitha kriteret të cilët janë paraparë sipas nenit 22? (Veljko Viquević, mbrojtës, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

(...) ngushtë të lidhur me personat të cilët janë nën hetime apo janë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare humanitare. Shikoni, kjo është i njëjti lloj i diskriminimit. Si është e mundur që fajësinë e prindit apo të të afërmit familjarë të bartet në familje apo në bashkëpunëtorë të afërt? (Veljko Viquević, mbrojtës, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

(...) cili organ apo autoritet e ka vërtetuar se është dyshim serioz? (Faton Ademi, Balkan Investigative Reporting Network, Kosovë, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

Neni 25

Përbërja dhe zgjedhja e Këshillave seleksionuese

1. Këshilli seleksionues në secilin shtet e përbëjnë 9 anëtarë/anëtare, të cilët duhet ti plotësojnë kriteret të cilat vlejné për përzgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të Komisionit, përveç ndalesës për kryerjen e funksioneve të theksuara politike në periudhën në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, dhe në periudhën e cila përfshihet në kompetencën e Komisionit.

Komentet

(...) neni 25, paragrafi 1, nuk është në përputhje me nenin 22, i cili thotë se – “Komisioni zgjedhor në secilin shtet do të përbëhet nga nëntë anëtarë të cilët duhet ti plotësojnë kriteret të cilët vlejné edhe për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit, përveç për kryerjen e funksionit të caktuar politik”. Pra, funksioni i shquar politik, para kësaj nuk përshkruhet askund, e as nuk përmendet. (Ivan Novosel, Legalis, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

2. Anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues nuk mund të kandidohen për anëtarësim në Komision.
3. Tre anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues i emëron ministri kompetent për të drejtat e njeriut, ose nëse një i tillë nuk ekziston në shtetin kontraktues, ministri kompetent për drejtësi, në pëlqim të Komisionit parlamentar ose të Komisionit kompetent për të drejtat e njeriut ose marrëdhënie ndërnacionale.
4. Tre anëtarë/anëtare të Këshillit seleksionues përzgjidhen nga anëtarët e Koalicionit për KOMRE në shtetin kontraktues.

Komentet

(...) të evidentohet këtu kush propozon. Anëtarët dhe anëtares e koalicionit në secilin shtet zgjedhin, por të mos vijmë te problemi se kush propozon, sa anëtarë dhe anëtare të koalicionit. (Maja Miqiq, Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut, Serbi Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

5. Gjashtë anëtarët/anëtares e para të Këshillit seleksionues emërohen, gjegjësisht zgjedhën në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni në afat prej 45 ditësh, nga dita e ratifikimit të fundit të Kontratës ndërkombëtare për themelimin e Komisionit.
6. Ministri kompetent shpallë zgjedhjen e katër anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit seleksionues, dhe në afat prej 8 ditësh shpall konkursin për zgjedhjen edhe të 3 anëtarëve/anëtareve të komisionit.
7. Gjashtë anëtarët/anëtares e përzgjedhur paraprakisht do vazhdojnë që tre anëtarët/anëtares e mbetur të Këshillit seleksionues ti zgjedhin me konsensus dhe nëse një gjë e tillë nuk do të jetë e mundur, atëherë zgjedhja bëhet me shumicë të votave.
8. Ministri kompetent, Koalicioni për KOMRE dhe anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues të zgjedhur në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, do të sigurojnë që së paku 1/3 të anëtarësisë ta përbëjnë femrat, gjegjësisht meshkujt, dhe do të përkushtohen që të sigurojnë që 1/3 të anëtarësisë ta përbëjnë përfaqësuesit/përfaqësueset e shoqatës së viktimave, duke përfshirë edhe shoqatat e viktimave të cilat nuk janë anëtare të Koalicionit për KOMRE, të regjistruara së paku tri vjet para nënshkrimit të kontratës për themelimin e Komisionit.
9. Ministri kompetent shpallë zgjedhjen e Këshillit seleksionues dhe i siguron kushtet për punën e tij.
10. Me Këshillin seleksionues kryeson anëtari/anëtarja më i moshuar dhe cakton mbajtjen e seancën konstitutive në afat prej 43 ditësh nga dita e shpalljes së konkursit nga paragrafi 6 të këtij neni.

Neni 26

Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim për Komisionin nga ana e komisionit seleksionues

1. Këshilli seleksionues, në afat prej 8 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive, shpallë konkurs për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, në afat prej 30 ditësh.

2. Në afat prej 8 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit, Këshilli seleksionues shpallë në internet faqen e Ministrisë kompetente sipas neni t 26, paragrafi 3, si vijon:
 - a. Numrin e përgjithshëm të kandidaturave të arritura;
 - b. Listën e emrave të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve janë refuzuar ose nuk kanë përmbajtur informacionet e kërkuara me konkurs, në lidhje me përmbushjen e kriterit të paraparë me nenin 23 të Statutit;
 - c. Listën e emrave të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve do të shqyrtohen,
3. Këshilli seleksionues mund të vendosë që ti intervistojë të gjithë ose disa prej kandidatëve/kandidateve. Intervista është e hapur për publik.
4. Këshilli seleksionues mund të kërkojë informata për kandidatin/kandidaten nga organet shtetërore dhe institucionet publike, ndërsa ato janë të obliguara që në kërkesë të Këshillit për qasje në informata të përgjigjen me urgjentsht.

Komentet

Në cilin bord për qasje në informata, po mendohet, sepse në kuadër të panelit selektues ekziston bordi, nuk është e qartë. (Maja Miqiq, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut, Serbi Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

5. Këshilli seleksionues do të përpiqet që të gjitha vendimet ti sjellë unanimisht, ndërsa në rastet kur konsenzusi është i pamundur, do të vendoset me shumicë prej pesë anëtarësh/anëtaresh.
6. Këshilli seleksionues vlerëson plotësimin e kushteve të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve i ka marrë në shqyrtim dhe e ngushton përzgjedhjen në listën e cila përmban numrin për dy deri në tre herë më të madh të kandidatëve dhe kandidateve nga nuri i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilit zgjedhën në shtetin kontraktues.
7. Në afat prej 40 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit Këshilli seleksionues shpallë listën e kandidatëve/kandidateve, dhe të njëjtën ia dërgon, po të njëjtën ditë, kryetarit/kryesisë së shtetit kontraktues.

Neni 28

Mbledhja konstitutive

1. Anëtari/anëtarja më e vjetër e Komisionit thërret mbledhjen konstitutive në selinë e Komisionit, në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjeve, dhe kryeson Komisionin deri në zgjedhjen e anëtarit kryesues/anëtares kryesuese.
2. Në pjesën solemne, hyrëse, të mbledhjes konstitutive të Komisionit, të hapur për opinion, marrin pjesë kryetari/anëtarët e kryesisë së shteteve kontraktuese.
3. Në pjesën hyrëse të mbledhjes konstitutive anëtarët/anëtares të Komisionit nënshkruajnë një ekzemplarë të Statutit, dhe nënshkruajnë dhe me nënshkrim, me zë lexojnë këtë deklaratë: “betohem me nderin tim që funksionin e anëtarit/anëtares të Komisionit do ta kryej në përputhje me Statusin, me përkushtim, me paanshmëri dhe i pavarur, duke u

përpjekur që të arsyetojë besimin e dhënë dhe të kontribuoj në realizimin e qëllimeve të Komisionit”.

Komentet

*(...) sa i përket komisionit, përmendet mbledhja konstitutive (themeluese), por askund më tutje **nuk përmendet se në çfarë forme komisioni i sjellë vendimet.** Përpos që është i nevojshëm kuorumi, a i sjellë ajo vendimet në takime(mbledhje)? Është e mundur që kjo të jetë e paraparë edhe më rregulloren e punës të vetë komisionit. A është e nevojshme prania fizike?* (Maja Miqiq, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

Neni 30

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Kuorumi për punë të Komisionit përbëhet nga 14 anëtarë/anëtares të Komisionit.
2. Komisioni bënë përpjekje që të gjitha vendimet e Komisionit ti nxjerr njëzëri, por kur konsensusi është i pamundur të arrihet, vendos me shumicën prej 14 anëtarëve/anëtareve.

Komentet

*Vetëm një sugjerim në nenin 2, paragrafi 30. – „**Komisioni synon që të gjitha vendimet të merren në mënyrë unanime, e kur nuk është e mundur të arrihet konsezeni, vendos me shumicë prej minimum katërmëdhjetë anëtarëve**“.* (Vesna Tersheliq, Dokumenta, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësi tranzicionale, Grupi punues: Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 16. tetor 2010.)

3. Komisioni mund të vendosë që për miratimin e vendimit procedural është i mjaftueshëm që të ekzistojë shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve dhe anëtareve.

KOALICIONI PËR KOMRA

DRAFT STATUTI I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS DHE SHKELJEVE TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË HAPËSIRAT E JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME

PJESA III - OBLIGIMI PËR BASHKËPUNIM ME KOMISIONIN

Neni 10

Obligimi i bashkëpunimit të shteteve me Komisionin

1. Të gjitha organet e pushtetit në shtetet kontraktuale, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe të njëjtë ti mundësojnë kryerjen e detyrave në përputhje me Statutin.
2. Organet kompetente të pushtetit në shtetin kontraktues, në kërkesë të Komisionit, me kohë do të sigurojnë qasje në të dhëna, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave dhe zbatimin e hulumtimeve në teren,

[ALT. A: në përputhje me dispozitat ligjore të shteteve.]

[ALT. B: përveç nëse me këtë do shkeleshin dispozitat ligjore të shtetit kontraktues mbi konfidencialitetin e të dhënave, ose nëse do të rrezikohet zbatimi i procedurës penale. Të dhënat, ose dokumentet, që kanë për qëllim fshehjen e veprës së kryer penale, ose që janë të drejtuara në shkelje të rënda të drejtave themelore të njeriut, nuk konsiderohen sekret shtetëror, ushtarak ose zyrtarë]

Komentet

(...) mendoj se do të ishte shumë keq nëse do të mbetej alternativa [B]. Sepse organet shtetërore do të mund të ndërhyjnë dhe të thonë – ju lutem, nuk mund t'ju lejojmë të kenë qasje në këto të dhëna sepse mund ta rrezikoni zbatimin e procedurës penale.

(Natasha Kandiç, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

3. Me rastin kur shteti konsideron që zbulimi i të dhënave të caktuara ose dokumenteve të cilat i ka kërkuar Komisioni do rrezikonin interesat ose sigurinë e tyre nacionale, do të ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të tejkalimit të situatës kontestuese, me angazhim të përbashkët të Komisionit dhe Shtetit. Këto masa nënkuptojnë:
 - (a) Deklarimi i Komisionit lidhur me atë sa janë relevante të dhënat dhe dokumentet të cilat i kërkon;
 - (b) Sqarimi ose ndryshimi i kërkesës,
 - (c) Shqyrtimi i mundësive të marrjes së të dhënave ose dokumenteve nga një burim tjetër ose në një mënyrë tjetër;
 - (d) Marrëveshja mbi kushtet e zbulimit të dhënave, duke përfshirë, ndër të tjera, zbulimin e pjesshëm të përmbajtjes së dokumenteve, kufizimi në publikimin e të

dhënave si dhe zbatimin e masave tjera mbrojtëse mbi konfidencialitetin e të dhënave.

Komentet

Mendoj se do të ishte mirë nëse komisioni nuk do të bashkëpunojë me organet individuale, me gjykatat dhe organet tjera të cilat kanë informata, por që shteti qysh gjatë marrëveshjes ndërkombëtare të caktojë një organ, se a do të jetë ajo një zyrë për bashkëpunim me komisionin apo diçka ngjashëm, dikush që do të jetë më operativ dhe do të mund të sigurojë ato më shpejtë. (Zharko Marković, Qendra për të drejtat e njeriut në Beograd, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Komentet

(...) organet shtetërore, edhe nëse ajo duhet të jetë me kërcënim të sanksioneve, të obligohen për bashkëpunim me KOMRA-në. (Gabriela Banić, avokate, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) për institucionet shtetërore, për organet shtetërore (...) madje është e nevojshme të shkruhen sanksione [në rast të mosbashkëpunimit me KOMRA-në]. (Nikolla Beshenski, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut, Vukovar, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Institucionet duhet të deklarohen me shkrim për bashkëpunim dhe dhënie të informatave, nuk do të duhej të sillet ndonjë udhëheqës i ndonjë organi dhe të dëgjohet. (Jasminka Bilosh, avokate, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

PJESA VI - KOMPETENCA E KOMISIONIT

Komentet

(...) një nga kompetencat më të rëndësishme të KOMRA-së, kur është fjala për marrëdhënien me gjyqësorin, thënë konkretisht, është përgatitja e të gjitha supozimeve dhe situatave kur është e mundur arritja e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Kjo nënkupton sjelljen e tyre në tryezë, natyrisht në situata të veçanta, edhe viktimën edhe kryesin e veprës penale, si dhe gjetjen e një mundësie të arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Një marrëveshje për pranimin e fajësisë, që do të formulohej në nivelin e KOMRA-së nuk do të thotë marrëveshje përfundimtare, por do të thotë një propozim shumë serioz dhe i respektuar për prokurorinë kompetente, që ta pranojë atë propozim dhe ta përmbyllë marrëveshjen (...) (Ibro Buliq, Prokuroria e BeH, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) KOMRA-së, duhet t'i jepet kompetenca që të mund t'i **ballafaqojë viktimat dhe kryesit e veprave**, dhe se një punë e tillë të themi hetuesie, të bëhet para KOMRA-së dhe për të duhet bërë një dokument të vlefshëm. (Ibro Buliq, Prokuroria e BeH, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 15

Marrja e deklaratave

1. Komisioni merr deklaratat mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda e të drejtave të njeriut, sipas kompetencës së vet, nga viktimat, dëshmitarët, kryerësit dhe personave të tjerë, për të cilët konsideron që mund të kenë njohuri për provat (faktet) relevante.
2. Çdo person të cilit, Komisioni, ia dërgon ftesën është i obliguar që të jep deklaratë për Komisionin. Viktimat nuk kanë obligim për të dhënë deklaratë pranë Komisionit për vuajturit ose vuajtjet e anëtarëve të familjes.

Komentet

Përvoja ime e profesionit të prokurorisë, më ka mësuar se nuk kam kurrfarë dobie nga dëshmitari të cilin e sjellë policia, të cilët së koti i kam ftuar, dhe nuk duan të vijnë, dhe pastaj na e sjellë policia, dhe pastaj ai dëshmitarë ulet dhe në çdo pyetje timen përgjigjet – nuk më kujtohet, nuk jam i sigurt... unë nuk kam kurrfarë dobie nga dëshmitarët e tillë. Ne këtu duhet ta përfaqësojmë idenë që të ftojme **dëshmitarët të cilët do të dëshmojnë në bazë vullnetare, t'i japin deklaratat e tyre**, dhe ato deklaratat – dëshmi do të jenë kualitative dhe relevante si në domenin e KOMRA-së po ashtu edhe në atë të ndjekjes penale. (Ibro Buliq, Prokuroria e BeH, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) kam frikë, se nëse nuk e fusim çështjen e obligueshmërisë, se komisioni nuk do të kuptohet seriozisht (...) ndërsa për tri vite sa do të jetë komisioni, sipas statutit, apo tri vite e gjysmë ose katër, nëse pranohet të shtyjë afatin e saj për gjashtë muaj, nuk është kohë e mjaftueshme që komisioni të bëhet mjaft i njohur dhe të pranohet nga njerëzit, nga popullata e zakonit, pra nga dëshmitarët potencial. (Ivan Jovanović, Misioni i OSBE-së në Serbi, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) **“secili person të cilit komisioni i dërgon thirrjen”, unë këtu do ta vija presjen (,) përveç viktimave dhe sërish presje (,) është e obliguar të japë deklaratë te komisioni”**. Këtu do të ishte pikë (.) dhe ky qëndrim do të ishte i kryer. **“Viktimat nuk kanë obligim”** – mendoj se kjo është nga aspekti i tekstit të ligjit, gjuhës ligjore, e tepërt, sepse asnjë **nen nuk do të duhej ta ketë këtë pikë**, sepse ajo është një fjali, neni është një fjali në ligj. (Velija Muriq, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut,

Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) unë do të lija në bazë vullnetare, sepse në bazë vullnetare është diçka që tingëllon mirë dhe ka efekt. Kjo tjetra nuk ka efekt. Mendoj, e qartë është se viktimat nuk kanë obligim të japin deklaratat, por ju mund ta thirrni secilin, dhe ai i cili dëshiron – ai do të vijë dhe do t'ju ndihmojë sinqerisht që të zbulohet diçka, por ai që nuk dëshiron – ai do të vijë dhe t'ju thotë se nuk e di apo nuk i kujtohet. (Jasminka Bilosh, avokate, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) mendoj se në bazë vullnetare duhet të mbetet edhe për dëshmitarët. (Nikola Beshenski, gjykatës në Gjykatën e Qarkut, Vukovar, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) që ndaj individëve të jetë posaçërisht në bazë vullnetare, pra të hiqen të gjitha imponimet në kuptimin e procedurave ligjore për veprat penale, dënimet etj, pra që njerëzit me të vërtetë të kenë dëshirë dhe vullnetarisht të paraqiten dhe ta thonë të vërtetën, të japin një pjesë të veten. (Gabriela Baniq, avokate, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

3. Në rast se personi refuzon për ti dhënë deklaratë Komisionit, duke u thirr në detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit e të dhënave, zbatohen dispozitat e nenit 10, paragrafit 2 dhe 3 të këtij Statuti.
4. Dispozitat e ligjit për procedurën penale në shtetin kontraktuese zbatohen në të drejtën e shkurtimit të dhënies së përgjigjes në çështjet e caktuara dhe lirimit nga detyrimi për të dëshmuar si dhe çështje të tjera lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, të cilat nuk janë të rregulluara me Statut ose me rregulloren e Komisionit.
5. Në kërkesë të dhënësit të deklaratës, Komisioni mund të mundësojë edhe dhënien e deklaratës në mbrojtje të identitetit.
6. Komisioni fton dëshmitarët sipas rregullave për thirrjen e dëshmitarëve, të sanksionuara në ligjet e procedurave penale në shtetet kontraktuese. Në kërkesë të Komisionit, Gjykata kompetente, me procedurë emergjente, vendos mbi zbatimin e masave të sigurisë për prezencën e dëshmitarit, duke përfshirë edhe caktimin e dënimeve procedurale për shkak të mos përgjigjes në ftesën e Komisionit, në përputhje me ligjin mbi procedurën penale të shtetit në të cilin bëhet ftesa. Komisioni mund të lidhë, me shtetet kontraktuese, marrëveshje të veçanta për bashkëpunim me

organet kompetente në procedurën e thirrjes dhe sigurimit të prezencës së dëshmitareve.

Komentet

*(...) ku ka kështu, që dikush t'i japë urdhër gjyqit se çka duhet të punojë? A është kjo në kundërshtim me funksionin e gjykatës, rolin e gjykatës të cilën gjykata e ka sipas kushtetutës? Këtë nuk guxojmë ta lejojmë sepse me këtë do të vijmë deri të një aninomitet që të diskutojmë për një **procedurë penale paralele**.* (Sinisha Shtimac, avokat, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

7. Komisioni i grumbullon deklaratat:
 - a. në vendbanimin apo në vendqëndrimin e dhënësit të deklaratës,
 - b. në zyret e Komisionit,
 - c. në ambasadat dhe konsullatat e shteteve kontraktuese, nëse kontrata merret në vendet e treta,
 - d. në territorin e shteteve të treta, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve, dhe në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund të japin deklaratat në konsullatat dhe ambasadat e shteteve kontraktuese.

Komentet

(...) parashtroj pyetjen – a do ti marrë parasysh KOMRA deklaratat, deklaratat relevante të dëshmitarëve atje ku është kryer procesi? (Safet Muratagić, Shoqata Çelësi i të ardhmes, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Ka logjikë vetëm nëse themi se duhet t'i marrim deklaratat e dëshmitarëve në të cilat deklarata bazohet akt-padia. (Natasha Kandić, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 17

Hulumtimet dhe vizitat në teren

1. Komisioni vërteton faktet (provat) relevante përmes hulumtimeve në teren, vizitës në lokalitetet e krimit, vendet e robërimit, varrezave masive dhe të gjitha lokaliteteve nga interesi për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda e të drejtave të njeriut, në bashkëpunim me pushtetin e shtetit kontraktues në të cilin territor kryhen hulumtimet.

Komentet

(...) do të bashkëpunojë me organet shtetërore (...) ky absolutisht nuk është formulim i mirë, KOMRA duhet të jetë e pavarur në hulumtimet e saj, gjegjësisht në hulumtimet në terren. (Natasha Kandiç, Fondi për të drejtën humanitare, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

2. Komisioni mund të vizitojë edhe lokacionet e krimeve dhe varrezave masive, me qëllim të shprehjes së pietetit ndaj viktimave.

Neni 18

Dëgjimi publik i viktimave dhe personave tjerë

1. Komisioni mban dëgjime publike në të cilat viktimat flasin mbi vuajtjet e tyre dhe të afërmeve të tyre.
2. Dëgjimet publike përfshijnë edhe kryerësit e veprave të cilët kanë karakter të krimit të luftës ose të shkeljeve të rënda e të drejtave të njeriut, dëshmitarët si dhe persona që iu kanë ndihmuar viktimave.
3. Dhënia e deklaratave në dëgjimin publik është me vullnet,
4. Me rastin e dëgjimeve publike Komisioni mund të aplikojë masa për mbrojtjen e identitetit, si dhe masa të veçanta për mbrojtje të integritetit psiko – fizik.
5. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht serviset publike, në hapësirat e ish RSFJ, kanë për detyrë të transmetojnë dëgjimet publike. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të transmetojnë dëgjimet publike, nën kushte të njëjta dhe sipas rregullave të cilat vlejnë dhe për mediet në pronësi shtetërore, përkatësisht servile publike.
6. Dëgjimet publike mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

Komentet

(...) nuk do mund të flasim për thirrjen e kryesit të veprës dhe për marrjen në pyetje të tij, e të mos ia mundësojmë të drejtën për prezencë edhe mbrojtësit ligjor të tij gjatë marrjes në pyetje të tij. (Ibro Buliq, Prokuroria në BeH, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 19

Mbajtja e sesioneve tematike

1. Komisioni mund të mbaj sesione mbi veprimin e institucioneve shtetërore, organizatave politike, enteve kulturore dhe shkencore, kishave dhe bashkësive fetare, dhe medieve para ose gjatë luftës, gjegjësisht formave të tjera të konfliktit të armatosur, dhe që kanë të bëjnë me kryerjen e krimeve të luftë dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut.

2. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht serviset publike, në hapësirat e RSFJ ish Jugosllavisë, kanë për obligim që të transmetojnë sesionet tematike të Komisionit. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të transmetojnë sesionet tematike, nën kushte të njëjta dhe sipas rregullave që vlejnë për media në pronësi shtetërore, gjegjësisht servile publike.
3. Sesionet tematike nuk mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

Komentet

(...) dhe për sesionet tematike, edhe këtu mendoj se baza vullnetare është shumë e rëndësishme, sepse nëse vjen dikush, jo në baze vullnetare, ndoshta pjesërisht do të pranojë se ka pasë lëshime – nuk fitoni asgjë, sepse nëse e formoni rreth tij murin mbrojtës, dhe do të shkoj deri në fund – te ne çdo gjë është mirë, ne të gjitha i kemi bërë mirë. (Nikola Beshenski, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut, Vukovar, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

PJESA XI - RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT

Neni 42

Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtarë

1. Para përfundimit të mandatit të vet Komisioni publikon Raportin përfundimtarë.
2. Komisioni dorëzon Raportin përfundimtarë kryetarëve/kryesisë së shteteve kontraktuese dhe, njëkohësisht i publikon (shpall) në të gjitha gjuhët zyrtare të shteteve kontraktuese.
3. Komisioni ka për obligim që njëkohësisht me dorëzimin e Raportit përfundimtarë të bëjë publik dhe të hapur rezymenë e tij.

Komentet

(...) dhe nëse shtojmë në nenin 42, paragraf të ri, që raporti përfundimtar t'i dorëzohet prokurorit publik, dhe pastaj me radhë institucioneve relevante shtetërore të cilat janë përgjegjëse për përndjekjen, kjo është akt padi e veçantë, kjo është thirrje e veçantë. Në këtë rast nuk do të duhej të ekzistonte neni 44, sepse ne nuk mund të themi se nuk ka rëndësi vendimi i gjykatës. (Velija Muriq, Komiteti për të drejtat e Njeriut, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 44

Gjetjet mbi kryerësit

1. Komisioni ka autorizim që në Raportin përfundimtarë të vërtetojë se faktet e grumbulluara tregojnë për atë që personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht

shkelje të rëndë e të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor.

Komentet

*(...) parashtroj pyetjen – çka nëse komisioni vërteton diçka dhe atë e publikon dhe pas saj zhvillohet procedura penale dhe personi lirohet dhe vërtetohet se ai nuk e ka kryer veprën (...) **Nuk mundemi që në interes të të drejtave të njeriut, poashtu të shkelim të drejtat e njeriut.*** (Jasminka Bilosh, avokate, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Kush do të jetë para komisionit, kush do të jetë kompetent, kush do të vlerësoj faktet e caktuara të cilat ne i kemi mbledhë, tregojnë në atë se personi i caktuar ka kryer krim lufte? Paj, e dini si, këtë e kanë vështirë ta caktojnë gjykatësit. Ata janë njerëz të cilët kanë përvojë, të cilët dinë ta bëjnë punën e tyre, ata duhet ta vërtetojnë(përcaktojnë) këtë. (Jasminka Bilosh, avokate, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Unë mendoj se KOMRA duhet absolutisht ta ketë kompetencën që në raportin e saj të mund të tregojë se një person i caktuar ka kryer krim lufte. Sepse, nëse KOMRA do të vazhdojë të bëjë vetëm mbledhjen e dëshmive të viktimave, mendoj se nuk kanë bërë shumë. (Ivan Jovanović, Misioni i OEBS-së në Serbi, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

2. Në raportin përfundimtar, Komisioni nuk mund të nxjerr gjetjet kundër ndonjë personi nëse nuk ka ndërmarr të gjithë hapat e arsyeshëm, që:
 - (a) Të njoftoj atë person lidhur me qëllimin e vet që të nxjerr gjetje jo të volitshme;
 - (b) Ti komunikojë personit përmbajtjen e gjetjes, të dhënat në bazë të të cilave nxirret gjetja, si dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjetja e tillë, dhe
 - (c) Ti ofrojë personit mundësinë që në afat të arsyeshëm të përgjigjet në gjetjen e propozuar.
3. Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkombëtare ose vendore, Komisioni mundet në raportin përfundimtarë të udhëzojë në aktgjykimin përkatës.

PJESA XII – TË NDRYSHME

Neni 46

Veprat penale dhe sanksionet

1. Çdo person i cili:
 - (a) me vetëdije jep të dhëna të rreme Komisionit, gjegjësisht personit i cili vepron në emër të Komisionit;
 - (b) që me kërcënim, forcë, veprim ose premtim të përfitimeve shtyn personin tjetër për të dhënë të dhëna të rrejshme ose mos dhënien e të dhënave Komisionit,
 - (c) asgjëson ndonjë dokument ose mjet me qëllim të pengimit të Komisionit që të zbaton hulumtimin, ose
 - (d) të zbardhë ose në ndonjë mënyrë tjetër zbulon të dhënë të cilën e ka pranuar Komisioni me kusht konfidencialiteti (neni 35 i Statutit),Konsiderohet se ka kryer vepër penale të dënueshme me dënim me burg deri në një vit, ose me dënim ekuivalent në të holla në shumën prej 5.000 euro.
2. Sanksionet nga paragrafi 1 zbatohen edhe ndaj personave zyrtarë të cilët pa ndonjë arsye refuzojnë të veprojnë sipas kërkesës së Komisionit, gjegjësisht personit i cili vepron në emër të tij.
3. Në rast se personi refuzon që ti përgjigjet ftesës, ose refuzon për të dhënë deklaratë para Komisionit, zbatohen dispozitat e nenit 15, paragrafi 6 i këtij Statuti.

Komentet

Ne nuk mund të përshkruajmë dënimin për dëshmi të rreme, por mund të udhëzojmë me marrëveshje në mënyrë indirekte në ligjin shtetëror, dhe me këtë kemi bërë një bapjas specifik në mes marrëveshjes dhe ligjit dhe kemi krijuar mundësinë e dënimit. . (Velija Muriq, Komiteti për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

[neni 46.] absolutisht nuk ka vend për këtë artikull, sepse ne nuk mund të flasim për atë se çka do të vlerësohet vepër penale, vepra penale është e përcaktuar me ligj. (Velija Muriq, Komiteti për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Unë do ta përfshij edhe konceptin dhënia e dëshmisë së rreme, pra do ta sillja këtë marrëveshje në nivel ligjor, dhe do ta përfshij edhe mundësinë e marrëveshjes për fajësinë (...) që të (...) aplikohen dispozitat ligjore të shteteve nënshkruese në kuptimin e ekspertizës, thirrjes. (Velija Muriq, Komiteti për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

(...) mogao bi statut REKOM-a kao međunarodni, međudržavni ugovor da propiše novo krivično delo.

(...) statuti i KOMRA-së, si marrëveshje ndërkombëtare, ndërshtetërore mund të përshkruajë vepër të re penale. (Ivan Jovanović, Misioni i OEBS-së në Serbi, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)

Neni 47

Roli i Komisionit në procedimin penal

Komisioni ka autorizime që:

- (a) të propozoj, në rast se personi për të cilin Komisioni disponon me indikacione serioze se ka kryer krim lufte ose shkelje të rëndë të drejtave të njeriut, të ia komunikojë Komisionit të dhënat me rëndësi për zbulimin e lokalitetit dhe mbetjet mortore të personave të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë, dhe ajo të merret nga ana e gjykatës kompetente – në rast të procedimit – si rrethanë lehtësuese me një rëndësi qenësore me rastin e shqiptimit të lartësisë së dënimit;
- (b) ti propozoj kryerësit të gjykuar për vepër penale falje të pjesërishme, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon Komisionit të dhënat e rëndësishme për zbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore për persona të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë; dhe
- (c) Të propozoj zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për personin të gjykuar, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon të dhënat e rëndësishme Komisionit për mbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore të personave të humbur, ose për zbulimin kryerësve të tjerë.

Komentet

(...) që në [paragrafin] të fshihen këto tri shkronja “apo”, “të mbetet “dhe” në vend “apo”. (Mirsad Dizdare, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit në Jajce, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Grupi punues: Kompetencat dhe marrëdhëniet e KOMRA-së me gjyqësorin, Zagreb, Kroaci, 16. Tetor 2010.)